

Nr. 682 prot
06.19.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIRKASTËR

Nr 318/1 prot

Gjirokastër, më 14.04.2021

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i Qarkut.



KËSHILLIT TË BASHKISË DROPULL

Jorgucat

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 106/2017 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 13, datë 31.03.2021, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024" **konfirmohet.**
2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 14, datë 31.03.2021, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Dropull, për vitin 2021" **konfirmohet.**
3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 15, datë 31.03.2021, "Për ngritjen e Komisionit të Apelitit Administrative të taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Dropull dhe miratimin e rregullores së funksionimit organizimit të këtij komisioni" **konfirmohet.**
4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 18, datë 31.03.2021, "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Dropull të një prone të paluajtshme shtetërore, kullotë me sipërfaqe 62209 m²" **konfirmohet**
5. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 19, datë 31.03.2021, "Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së këshillit në procesin e vendimmarrjes për vitin 2020" **konfirmohet**
6. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 20, datë 31.03.2021, "Për miratimin e rregullores së strukturave komunitare dhe ndërveprimi i tyre me këshillin bashkiak" **konfirmohet**

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

PREFEKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 5813 Prot

Jorgucat , më 31.03.2021

VENDIM

NR. 15 DATE 31.03.2021

“PERNGRITJEN E KOMISIONIT TE APELIMIT ADMINISTRATIV TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PRANE BASHKISE DROPULL DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SE FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZMIT TE KETIJ KOMISIONI”

Ne mbështetje nenit 54, shkronja "k" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 te ligjit nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise", ligjit nr. 68, date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", te ndryshuar; ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 te ministrit te Financave "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar; vendimit nr. 132 date 07.03.2018 te Keshillit te Ministrave "Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme "ndertesa", e hazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e hazes se takses, si dhe kriterëve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses", ne mbledhjen e dates 31.03.2021 me propozim te kryetarit te Bashkise, Keshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e komisionit te apelimit administrativ te taksave dhe tarifave vendore prane Bashkise Dropull.
2. Miratimin e rregullores per organizimin dhe funksionimin e komisionit te apelimit administrativ te taksave dhe tarifave vendore, sipas tekstit bashkelidhur dhe pjese perberese e ketij vendimi.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkise, dhe administrata per zbatimin e ketij vendimi.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve te pikes 6 te nenit 55 te ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" te ndryshuar dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit te Qarkut Gjirokaster

Sekretar I Keshillit
Urania Kuremeno

KRYETAR
Donika Bauçi

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundra -



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL

RREGULLORE PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TE APELIMIT ADMINISTRATIV TE TAKSAVE
DHE TARIFAVE VENDORE

Neni 1

Komisioni Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore

1. Prane Bashkise Dropull ngrihet dhe funksionon Komisioni i Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore, me poshte e ne vijim Komisioni i Apelimit.
2. Komisioni i pelimit shqyrton dhe merr vendime ne lidhje me ankesat administrative te paraqitur nga tatimpaguesit ne lidhje me taksat dhe tarifat vendore te Bashkise Dropull
3. Komisioni i Apelimit perbehet nga 5 anetare, i perbere si me poshte:
 - a. Zevendeskryetari bashkise;
 - b Nje jurist
 - c .Nje perfaqesues te Drejtorise se te Ardhurave
 - ç Nje perfaqesues te Drejtorise se Menaxhimit Financiar
 - d. Nje perfaqesues te Drejtorise te Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit
4. Anetaret e Komisionit te Apelimit, si rregull duhet te jene me arsim te larte si dhe te kene te pakten dy vjet pervojë ne profesion apo adrninistraten publike.
5. Komisioni ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë brenda pese diteve nga hyrja ne fuqi e kesaj rregulloreje .Anetaret emerohen per një mandat 2 vjeçar me të drejtë riemërimi. Në rast të nevojës për ndryshim/zëvendësim të anëtarëve të komisionit, kryetari i Bashkisë bën ndryshimin/zëvendësimin e anëtarit përkatës me një punonjës tjetër.
6. Komisioni zhvillon mbledhjen e tij te pare brenda 7 diteve pune nga hyrja ne fuqi e urdhrit te kryetarit te bashkise. Ne mbledhjen e pare, komisioni apelimit zgjedh kryetarin.
7. Kryetar zgjidhet kandidati qe merr te pakten 3 vota
8. Ne rast se nuk arrihet zgjedhja e kryetarit kur ka me shume se nje kandidat, pasi asnjeri nuk merr votat e mjaftueshme, edhe pas raundit te dyte te votimit, atehere ata ernerohen me urdher te kryetarit te bashkise Dropull.
9. Me urdhër të veçantë të Kryetarit të Bashkisë, përcaktohet sekretari administrativ i Komisionit te Apelimit, punonjës i Drejtorisë se te Ardhurave, i cili nuk është anëtar i këtij komisioni. Sekretari administrativ duhet të jetë i diplomuar në shkenca ekonomike ose juridike, të ketë njohuri të mira në nivel teknik mbi legjislacionin tatimor si dhe të ketë të paktën 2 vite përvojë pune.
10. Kryetari dhe anetaret e komisionit mund te ndryshohen ne cdo kohe, ne rastet kur:
 - a. nuk marrin pjese ne tri mbledhje radhazi te komisionit, pa shkaqe te justifikuara
 - b. japin doreheqjen

- c. .jane ne kushtet e konfliktit te interesit, sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi
- d .perfundojne marredhenien e punes me bashkine
- e. behen te paafte nga ana shendetesore per te kryer funksionet e ngarkuara

Neni 2

Kompetencat dhe detyrat e komisionit

1.Kryetari i Komisionit, ushtron keto detyra:

- cakton daten dhe vendin e zhvillimit te mbledhjes se komisionit dhe vendos per rendin e dites se cdo mbledhjeje
- drejton zhvillimin e mbledhjeve te komisionit;
- mbikeqyr veprimtarine e sekretariatit te komisionit
- cakton anetarin/anetaret qe do te relatojne ankimin per shqyrtim nga Komisioni ne mbledhjen e radhes
- raporton per ecurine e veprimtarise se Komisionit prane Kryetarit te Bashkise brenda muajit dhjetor te cdo viti ose sa here i kerkohet prej tij
- rruan konfidencialitetin e informacionit te marre gjate ushtrimit te funksioneve te tij
- nenshkruan vendimet e Komisionit, ne perputhje me parashikime e Kodit te Procedurave Administrative

2 Anetaret e Komisionit ushtrojne keto detyra:

- marrin pjese rregullisht ne mbledhjet e Komisionit dhe njoftojne paraprakisht ne rast mungese duke paraqitur dhe arsyet e mungeses;
- votojne per ceshtjet e rendit te dites, bazuar ne parimin e profesionalitetit dhe Ndershmerise
- deklarojne, para votimit per cdo ceshtje, nese jane ne kushtet e konfliktit te interesit;
- secili prej anetareve relaton para komisionit ceshtjen e caktuar
- ruajne konfidencialitetin e informacionit te marre gjate ushtrimit te funksioneve te tyre.
- nenshkruajne vendimet e Komisionit, ne perputhje me parashikimet e Kodit te Procedurave Administrative

3. Sekretariati administrativ i Komisionit ushtron keto detyra

- Merr ne dorezim ankimet qe jane objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes se Komisionit
- Shperndan dhe ve ne dispozicion te anetareve, materialet per mbledhjen e radhes, brenda 5 diteve pune para dates se mbledhjes
- Njofton kryetarin e komisionit per cdo ankimim te paraqitur per shqyrtim dhe u njofton anetareve daten e marrjes ne shqyrtim te ankimit
- Njofton ankimuesin te pakten 7 dite pune perpara per ditën, oren dhe vendin e zhvillimit te mbledhjes se Komisionit
- mban dhe harton procesverbalin e mbledhjes
- Zbardh vendimin e arsyetuar te marre ne mbledhjen e Komisionit;
- Ruan konfidencialitetin

4. Komisioni gjate shqyrtimit te nje ankimi ka te drejte te kerkoje nga palet cdo informacion shtese, ose te dhena plotesuese qe i gjykon te nevojshme, si dhe ka te drejte te beje verifikime, ne funksion dhe per qellime te shqyrtimit te ankimit.

Neni 3

Organizimi, procedura dhe zhvillimi i mbledhjeve

1. Komisioni mblidhet me kërkesën Kryetarit ose e të pakten 2 anetareve të tij, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e depozitimit të ankimit.
2. Rendi i ditës dhe data e mbledhjes caktohet nga kryetari dhe u njoftohet anetareve të komisionit nepermjet sekretariatit, të pakten shtatë ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.
3. Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm të pakten 3 anetare të komisionit. Në rast se nuk arrihet numri i anetareve të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, atëherë brenda tre ditëve përpara, caktohet një datë tjetër.
4. Cdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë, cdo anetari dhe personi që ka paraqitur ankimin ose përfaqësuesit të tij. Komisioni mund të mblidhet më shumë se një herë për të njëjtën çështje sipas nevojës.
5. Vendimet në cdo rast merren me shumicën e thjeshtë të votave të anetareve të Komisionit të pranishëm në mbledhje. Komisioni merr vendime vetëm për kërkesa për apelim, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.
6. Në cdo mbledhje mbahet një procesverbal me shkrim, në të cilin pasqyrohet një përmbledhje të gjithë procesit: datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsyetimi, vendimet që u morën, si dhe rezultati i votimeve.
7. Procesverbali mbahet nga sekretarii dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillimin e mbledhjes pasardhëse.

NENI 4

Objekti i apelimit

1. Është objekt ankimi pranë komisionit të apelimit cdo akt administrativ apo mosveprim nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave për nxjerrjen e një akti administrativ në lidhje me një takse dhe/ose tarife vendore. Për këtë qëllim, akt administrativ konsiderohen të gjitha aktet e nxjerra nga Drejtoria e të Ardhurave që shkaktojnë efekte financiare dhe/ose ligjore në mënyrë individuale për cdo taksapagues.
2. Vendimet administrative që mund të ankimohen përfshijnë cdo njoftim vlerësori apo akt tjetër administrativ që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit, përfshirë llogaritjen e gjobave dhe/ose gabimet në llogaritjen e kamatëve.
3. Ankimi mund të bëhet edhe kundër një mosveprimi të Drejtorisë së të Ardhurave që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit (p.sh. një akt që nuk është miratuar nga Bashkia Dropull apo Keshilli Bashkiak brenda periudhës së përcaktuar në ligj, pavarësisht nëse taksapaguesi ka bërë kërkesë në lidhje me të).
4. Është objekt ankimi cdo akt administrativ vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndertese, për qëllime të takses së ndertës.

5. Ankimi mundte behet nga vete aksapaguesi apo nga perfaqesuesi i tij dhe mund te perfshije apelimin e disa vendimeve administrative ne te njejten procedure

6. Gjate procedures se shqyrtimit te ankimit, Komisioni i Apelimit, ka te drejte te grupoje se bashku disa ankime te ngjashme me qellim te maksimizimit te eficiences ne proceduren e ankimit

7. Aktet e Komisionit te Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore, qe rezultojne nga procedura e ankimit nuk mund te jene objekt ankimi administrativ. Keto vendime mund te ankimohen vetem ne gjykate

Neni 5

Ankimi ndaj vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme "ndertese"

1. Cdo subjekt taksapagues, per qellime te vleres se takses se nderteses, pas marrjes se njoftimit te detyrimit per taksen e pasurise, ka te drejte te kundërshtoj administrativisht vleresimin e bere nga autoritetet perkatese te vleres se pasurise se paluajtshme per kategorine ndertese, Nje kerkese e tille mund te paraqitet edhe ne rast se ankirnuesi gjykon se ndertesa e tij eshte objekt perjashtimi nga ligji.

2. Fillimisht subjekti paraqet nje kerkese per korrigjimin e te dhenave ne lidhje me, llogaritjen e takses ne rastet e saktësimit te informacionit per siperfaqen, vendndodhjen zonale, qellimin e perdorimit te nderteses dhe cmimeve perkatese

3. Taksapaguesi ka te drejte ne cdo kohe qe te kerkoj korrigjimin e te dhenave ne lidhje me llogaritjen e takses se nderteses ne rastet e saktësimit te informacionit per siperfaqen, vendndodhjen zonale, qellimin e perdorimit dhe cmirnet perkatese, apo kur gjykon se vleresimi i pasurise se tij te paluajtshme ndertese nuk eshte bere ne perputhje me parashikimet e vendimit nr 132 date 07.03.2018 te Keshillit te Ministrave "Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme "ndertesa", e baze se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktirnin e baze se takses, si dhe kriteret dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses".

4. Kerkesa per korrigjimin e vleres per taksen e pasurise bëhet pranë Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë e shoqëruar me dokumentacionin justifikues e plotësues.

5. Drejtoria e te Ardhurave, brenda 30 (tridhjetë) diteve, bejne shqyrtimin e kerkeses se subjektit dhe vendos.

- Te pranoje kerkesen per korrigjim dhe ben korrigjimin e vleres nese vleresimi fillestar eshte bazuar mbi te dhena te gabuara apo ka gabime ne perllogaritje

- Te refuzoje kryerjen e korrigjimit dhe arsyeton me vendim arsyet e refuzimit te kerkeses per korrigjim.

Procedurat e korrigjimit, nuk kushtëzohen me ndonjë detyrim nga ana e tatimpaguesit për të parapaguar taksën për të cilën është bërë kërkesa për korrigjim.

6. Nese taksapaguesi nuk bie dakord me vendimin e Drejtorise se te Ardhurave per taksen e nderteses ndaj kerkeses per korrigjim, atehere ai ka te drejte te ankohe pranë Komisionit te Apelimit brenda nje afati prej 30 ditesh nga data kur eshte marre apo konsiderohet te jete marre njoftimi

7. Kane te drejte te paraqesin ankim pronaret e ndertesesh/njesise pronesore apo perdoruesit

e saj, personat qe kane aplikuar per legalizim te ndertesesh, sipas ligjit "Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje" dhe zhvilluesit te cilet nuk arrijne te perfundojne ndertimin brenda afateve te percaktuara ne lejen perkatese, te leshuar nga autoriteti perkates i planifikimit

8. Taksapaguesi mund te ankimoje taksen mbi pasurine e paluajtshme/ndertese pasi vleresimi i takses se pasurise nuk eshte i drejte si rezultat:

- Te dhenave te pasakta
- Vendndodhjes se pasurise dhe cmimeve perkatese
- Normes tatimore te pasakte, bazuar ne qellimin e perdorirnit te pasurise
- Dhe cdo arsye tjeter qe ndikon ne detyrimin e tij tatimor

9. Komisioni i Apelimit, ne lidhje me ankimin e vleresimit te pasurise se paluajtshme/ndertese kryen keto detyra

- Planifikon dhe mban mbledhje te rregullta per shqyrtimin e ankimeve, brenda nje periudhe prej 30 dite kalendarike, nga dita e pranimit te ankimeve.
- Mund te kerkoje pranine e ankimesit, per degjirn para ketij Komisioni per te sqaruar arsyen e ankimit dhe per te sjelle cfaredo dokumenti apo prove qe mund ta mbeshtese ankimin;
- Mund te kerkoje te dhëna shtese nga Drejtoria e te Ardhurave
- Mund te inspektojë pronën e paluajtshme, kur vlerësohet se një veprim i tillë është në shërbim të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

10. Ne perfundirn te shqyrtimit te ankimit, Komisioni i Apelimit, vendos:

- Refuzimin e ankimin per shkak se e konsideron te papranueshem per rnungese te kritereve formale te percaktuara ne kete rregullore
- Lenien ne fuqi aktin administrativ objekt apelimi
- Shfuqizimin e aktit administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë e te Ardhurave për të reflektuar ndryshimet në Regjistrin e bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme
- Shfuqizimin pjesërisht te aktit administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë e te Ardhurave për të reflektuar ndryshimet në Regjistrin e bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme;

11. Procedurat e korrigjimit, nuk kushtezohen me ndonje detyrim nga ana e tatimpaguesit per te parapaguar taksen per te cilen eshte bere kerkesa per korrigjim

12. Nese taksapaguesi perseri nuk bie dakord me vendimin e dhene nga komisioni apelimit, idrejtohet Gjykates Administrative

Neni 6

Ankimi ndaj aketeve administrative apo mosveprim nga Drejtoria e te Ardhurave

1. Taksapaguesi ka te drejte te ankimoje ne komisionin e apelimit, cdo:

- Akt administrativ te Drejtorise se te Ardhurave
- Veprim apo mosveprim te Drejtorise se te Ardhurave dhe ky veprim apo mosveprim ka te beje me takspaguesin
- Akt administrativ konsiderohen të gjitha aktet e nxjerra nga Drejtoria e te Ardhurave që shkaktojnë efekte financiare dhe/ose ligjore për çdo taksapagues individualisht



Neni 7

Aktet qe nuk mund te ankimohen ne Komisionin e Apelimit

Aktet qe nuk mund te ankimohen prane Komisionit te Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore jane:

- Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administrates tatimore vendore qe nuk ndikojne ne detyrimin tatimor vendor te taksapaguesit;
- Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administrates tatimore vendore qe shkelin te drejtat e tatimpaguesve sipas Ligjit "Per procedurat tatimore";
- Masat administrative te mbledhjes me force te detyrimeve
- Ne perputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI te Ligjit "Per procedurat tatimore", masat administrative te parashikuara sipas ketij kreu dhe ne kapituj te tjere te ketij ligji qe kane te bejne me masat e mbledhjes me force, nuk jane objekt apelimi administrativ prane Komisionit te Apelimit

Neni 8

Ankimi ndaj masave te barres siguruese apo hipotekore

1. Pavaresisht, parashikimit te nenit me siper, taksapaguesi ndaj pasurise se te cilit ka dale nje vendim per vendosjen e masave te sigurise, ne fornjen e barres siguruese apo hipotekore, ka te drejte te paraqese ankese tek Drejtori I te Ardhurave , vetem ne ato raste kur zbatimi i masave te sigurise nuk eshte ekzekutuar ne r menyre te rregullt

2. Konsiderohet se ekzekutimi i vendimit per marrjen e masave te sigurise nuk eshte kryer ne rregull ne rastet e meposhtme

- Kur taksapaguesi nuk ka pasur njoftim me shkrim per sigurimin e detyrimit tatimor, brenda afateve kohore te parashikuara nga Ligji "Per procedurat tatimore"

- Kur gjate periudhes se daljes se vendimit dhe ekzekutimit te tij, detyrimi tatimor vendor eshte paguar;

- Nese pasuria e vendosursi barre siguruese apo hipotekore, eshte ne grupin e sendeve mbi te cilat nuk mund te shtrihet ekzekutimi sipas nenit 529 te Kodit te Procedures Civile

-Kur akti me ane te te cilit kerkohet te veprohet per ekzekutimin per mbledhjen me force te taksave dhe tarifave vendore ka dale jo ne emer te taksapaguesit por kundrejt nje person tjeter. Akti administrativ i konfiskimit i mbajtur sipas nenit 122 pika 4 te ligjit "Per procedurat tatimore", ne perputhje me Kodin e Procedures Administrative ankirnohet administrativisht tek Drejtori Ite Ardhurave

3 Taksapaguesi, ne rast se ka konstatuar parregullsi ne ekzekutimin e vendimit, e ushtron te drejten e ankimit brenda 30 diteve nga data e konstatimit te tyre

4. Ne cdo rast, ne ankesen e tij, taksapaguesi eshte i detyruar t'i provoje Drejtorise se te Ardhurave momentin se kur ai ka marre dijeni per nje parregullsi, gjc e cila duhet te provohet me ane te provave shkresore

Drejtoria e te Ardhurave ne perfundim te shqyrtimit, brenda 30 diteve kalendarike prej marrjes se kerkeses, vendos:



a-Te refuzojë kërkesën nëse nuk është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditesh nga data e konstatimit të parregullsise

b-Te lër në fuqi vendimin e masës së sigurisë, bare sigurie apo hipotekore

c-Kundër vendimit të pikës a dhe b, taksapaguesi mund të ankimojë tek Komisioni e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore

d-Shfuqizon plotësisht apo pjesërisht vendimin e masës sigurorese, barrë sigurorese apo barrë hipotekore.

Neni 9

Dorezimi i ankimit administrativ

1. Ankimi duhet të bëhet brenda 30 diteve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë. Njoftimi konsiderohet të jetë marrë nga taksapaguesi brenda 10 (dhjetë) diteve kalendarike pas pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Në rastet kur dita e fundit e afatit bie në ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

2. Në rastet kur në aktin administrativ mungon njoftimi që informon taksapaguesin për të drejtën e tij për të ankimuar aktin administrativ, përfshirë afatin dhe të drejtën e apelit, taksapaguesi mund të ankimojë brenda 3 (tre) muajve nga data kur akti administrativ është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë.

3. Në rast mosveprimi të administratës tatimore vendore apo agjentit tatimor (refuzimi për të nxjerrë një akt), procedura e ankimit fillon tre muaj pas dësës së dorezimit të kërkesës fillestare për nxjerrjen e aktit administrativ.

4. Në qoftë se ankimi pranë Komisionit të Apelit nuk bëhet brenda afatit të caktuar, ai konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

5. Taksapaguesi mund të kërkojë rivendosjen në afat vetëm nëse është penguar për shkak të arsyeshme respektimi i afatit procedural. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 diteve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet dorezuar edhe ankimi pranë Komisionit të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

6. Ankimi duhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankimesi. Gabimet jo materiale, ortografike, apo mungesa që nuk prekin vlefshmerinë apo thelbin, nuk përbejnë arsye për mos marrjen në shqyrtim të apelit.

7. Ankimi dorezohet pranë zyres së protokollit të Bashkisë drejtpërdrejtë nga taksapaguesi ose nëpërmjet shërbimit postar.

8. Dokumentacioni shoqëruar që i bashkëngjitet ankimit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën e taksapaguesit
- numrin identifikues të regjistrimit të taksapaguesit
- aktin administrativ, të leshuar ose të pa leshuar nga organ tatimor, që është objekt ankimi duke përfshirë periudhën tatimore përkatëse dhe shumën e detyrimit tatimor
- pagesën e detyrimit tatimor që ankimohet
- arsyet për ankimin e tij,

- informacion ne mbeshtetje te ankimit (Aktin e kontrollit, proces-verbalet, etj.)
- cdo dokument tjeter qe ankimuesi e gjykon te rendesishem
- nenshkrimin e tij

9. Ne qofte se nuk plotesohet ndonje prej kerkesave te permendura ne kete nen,

Komisioni Vendore i Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore i kerkon taksapaguesit ta ridergoje ankimin e tij te plotesuar si duhet me informacionin e kerkuar brenda 15 diteve kalendarike.

10. Taksapaguesi nuk mund te apeloje ne gjykate nje akt administrativ qe eshte object apelimi pa pasur nje vendim te ketij kornisioni hdhur me kete akt administrativ.

11. Ne rastet kur Komisioni Vendore i Apelimit nuk shprehet brenda 60 diteve nga data e marrjes se ankimit, taksapaguesi mund te ankohe drejtperdrejt ne gjykate.

Neni 10

Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi

1. Tatimpaguesi, i cili kerkon te ankimoje, sipas pikës 1 të nenit 106 dhe nenit 107 të ligji, ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar duhet qe bashke me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati, sipas të cilit vendimi ka marrë formë të prerë për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose suma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjrobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore. Në rastin kur Këshilli Bashkiak, ka vendosur në favor të parapagimit, ankimi pranohet në qoftë se ankimuesi:

a. parapaguan shumën e plotë/pjesshëm të detyrimit tatimor, objekt ankimi të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet, përfshirë ose jo kamatëvonesat/gjrobat përkatëse, ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati sipas të cilit vendimi merr formë të prerë;

b. vërteton pagesën ose garancinë, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi ose të garancisë bankare. Taksapaguesi pajiset nga Drejtoria e të Ardhurave me një dokument urdhër pagesë ku pasqyrohet saktësisht detyrimi tatimor për t'u paguar. Në qoftë se taksapaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ose nuk vendos garancinë bankare, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Neni 11

Vendimi dhe arsyetimi nga Komisioni i Apelimit

1. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendime bazuar ne provat dhe argumentet e paraqitura nga taksapaguesi dhe administrata tatimore vendore per ankimet e paraqitura nga taksapaguesit.

2. Komisioni Apelimit mund te kerkoje informacion shtese, dokumente te tjera nga taksapaguesi, nga Drejtoria e te Ardhurave, agjentet tatimor, nga pale te tretat, si dhe mund te beje verifikime qe ndihmojne ne shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejte te ceshtjes,

3. Komisioni i Apelimit kufizon shqyrtimin e ankimit vetem ne ceshtjet e ngritura nga taksapaguesi ne ankim. Ne qofte se gjate procedures zbulohen fakte te reja qe provojne se detyrimi tatimor i percaktuar nuk eshte i mjaftueshern, Komisioni i Apelimit nuk mund ta rrise vete detyrimin tatimor. Ne kete rast ky komision informon me shkrim Drejtorine e te Ardhurave duke i vene ne dijeni per rrethanat e reja te lindura gjate ankimit administrativ

4. Komisioni i Apelimit ka te drejte te shqyrtoje dhe te anuloje gjoba, plotesisht apo pjeserisht, pavaresisht nga vlefshmeria e detyrimit tatimor, ne rastet e parashikuara ne perputhje me nenin 111 te ligjit "Per procedurat tatimore". Ky gjykim bazohet ne analizimin e plote te arsyeve dhe rrethanave ne te cilat eshte kryer shkelja, duke evidentuar faktet dhe argumentet e mbi bazen e te cilave behet gjykimi dhe merret vendimi.

5. Ne perfundim te shqyrtimit te ceshtjes, Komisioni i Apelimit, vendos:

- Te refuzoje ankimin per shkak se e konsideron ankimin te papranueshern
- Te rrezoje ankimin
- Te anuloje aktin administrativ objekt ankimi duke pranuar ankimin ose te pranoje ankimin (pjeserisht ose plotesisht) dhe ta ndryshoje aktin administrativ objekt ankimi

6. Vendimi Komisionit te Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet te perfshije nje shpjegim me shkrim te menyres se arsyetimit sic parashikohet ne nenin 100 te ligjit te Procedurave Administrative. Vendimi nenshkruhet nga kryetari dhe anetaret e Komisionit te Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore

7. Arsyetimi duhet te jete i qarte dhe te perfshije shpjegimin e bazes ligjore dhe faktike te aktit. Kur arsyetimi eshte bere mbi bazen e informacioneve apo propozimeve te meparshme, mund te mjaftoje si arsyetim pranimi i tyre nga ana e organit pergjegjes per marrjen e vendimit perfundimtar. Ne keto raste informacionet dhe propozimet jane pjese perberese e vendimit perfundimtar.

8. Vendimi duhet te perfshije nje dispozite qe ve ne dijeni taksapaguesin per te drejten e tij per ankimin e vendimit ne gjykate dhe i dergohet taksapaguesit dhe Drejtorise se te Ardhurave qe ka nxjerre vendimin objekt ankimi.

9. Perdorirni per arsyetim i te dhenave te paqarta, kontradiktore ose te pasakta eshte i barasvlershern me mungesen e arsyetimit. Ne rastet e ceshtjeve analoge mund te perdoren arsyetimet e bera ne ceshtjet e meparshme

10. Komisioni i Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore, mund te rrezoje nje ankim ne qofte se:

- gjykon qe ankimi eshte i pabazuar pasi procedura eshte ndjekur sipas rregullit dhe akti administrativ ka gene i drejte dhe ligjerisht korrekt, ndersa ankimi eshte i pabazuar

- zbulon qe ka pasur mosveprime (ose gabime te administrates tatimore), por qe ato kane qene aq te parendesishme sa qe nuk mund ta kene ndikuar ne vendimin administrative
- akti administrativ eshte bazuar ne ligj, por per arsye te tjera nga ato te shprehura ne akt, ajo shpjegon keto arsye ne vendim

11. Komisioni i Apelimit ploteson proceduren dhe eliminon mungesat vete ose mund t'ia kerkoje kete gje Drejtorise se te Ardhurave , ne rastet kur

- Konstaton qe faktet ne procedure j ane percaktuar me mungesa dhe gabime
- Veren se procedura e ndjekur nuk eshte ne perputhje me rregullat procedurale qe mund te kene ndikuar aktin administrativ; ose
- Konstaton qe permbajtja e aktit administrativ te kundërshtuar eshte e paqarte ose bie ndesh me shpjegimet e tij

12. Komisioni i Apelimit ne baze te fakteve te vertetuara gjate procedures, vendos anulimin e aktit administrativ dhe vendos vete per zgjidhjen e ceshtjes ose i kerkon Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore ta zgjidhe ate nese konstaton qe kjo e fundit

- I ka vleresuar provat gabimisht
- Ka nxjerre konkluzion te gabuar nga faktet e parashtruara
- Ligji ne baze te te cilit eshte marre vendimi eshte zbatuar gabimisht; ose
- Komisioni i Apelimit eshte e mendimit qe duhej marre nje vendim i ndryshern nga ai me pare.

13. Ankimuesi mundte heqe dore nga ankimi para nxjerrjes se vendimit te ankimit Ne kete

rast, procedura e ankimit nderpritet me nje vendim per mbylljen e procedures sc ankimit

Neni 12

Afati i shqyrtimit te ankimit nga Komisioni i Apelimit

1. Komisioni i Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore vendos brenda 60 diteve nga dita e marrjes se ankimit
2. Ne rast se dita e fundit e ketij afati bie ne dite pushimi apo feste zyrtare, afati shtyhet ne ditën pasardhese te punes. Ne qofte se ankimi nuk permbush kriteret formale afati 60-ditor fillon nje dite pas plotesimit te kerkesave formale nga ankimuesi por jo me vone se 30 dite kalendarike pas marrjes se ankimit
3. Ne asnje rast koha e shqyrtimit te ankimit nga Komisioni i Apelimit nuk mund te kaloje 90dite duke filluar nga data e marrjes se ankimit
4. Kur Komisioni i Apelimit nuk shprehet me vendimin brenda 60 ditesh nga plotesimi i ankimit, taksapaguesi mund te ankohet drejtperdrejte ne gjyrate
5. Ne rastet kur vendimi i ankimit varet plotesisht ose pjeserisht nga nje ceshtje e rreparshme qe eshte subjekt i procedurave gjyqesore ose eshte nen juridiksionin e nje organi tjeter publik, Komisioni i Apelimit, mund te nxjerre nje vendim te perkohshem per pezullimin e procedures deri ne zgjidhjen e ceshtjes per te cilen eshte pezulluar
6. Ne rastin e pezullimit te nje procedure, vendimi perfundimtar i Komisionit te Apelimit duhet te nxirret brenda gjashte muajsh nga data e marrjes se ankimit te plotesuar si duhet, perndryshe ankimuesi mund te ankimoje drejtpersedrejte ne gjyrate



Neni 13

Ankimi kunder vendimit te Komisionit te Apelimit

1. Taksapaguesi ka te drejte te beje ankimim ne rruge gjyqesore kunder vendimit te Komisionit te Apelimit brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes dijeni te vendimit
2. Ne qoftese taksapaguesi nuk eshte njoftuar ne menyre te rregullt ose nuk ka marre dijeni me qellim per te drejten e ushtrimit te ankimit te vendimit te Komisionit te Apelimit ankimi ne gjykate ne kete rast behet brenda 3 (tre) muajsh nga data e hyrjes ne fuqi te vendim
- 3 Ne mungese te nje vendimi te Komisionit te Apelimit, mund te behet ankim ne rruge gjyqesore vetem ne rastet kur:
 - Akti administrativ nuk perfshihet ne objektin e apelimit sipas nenit 4 te kesaj rregulloreje; ose,
 - Komisioni i Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore nuk nxjerr vendim brenda 60 ditesh pas marrjes se ankimit te plotesuar, ose ne rast pezullimi, nuk nxjerr vendim brenda gjashte muajsh pas marrjes se ankimit te plotesuar
- 4.Per nje akt administrativ objekt ankimi, nuk mund te behet ankim drejtpersedrejti ne gjykate pa u ezauruar ankimi administrativ.

Neni 14

Rimbursimi i detyrimit tatimor vendor, kamatevonesave dhe/ose gjobes ne rastet e parapagimit gjate procesin e ankimit administrative

1. Nese vendimi i Komisionit te Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore eshte ne favor te taksapaguesit, detyrimi i parapaguar nga taksapaguesi, i rimbursohen taksapaguesi brenda 30 diteve kalendarike nga data kur eshte marre ose vleresohet te jete marre vendimi nga ana e Komisionit Vendore te Apelimit.
2. Nese taksapaguesi ka paraqitur garanci per pagesen e detyrimit, kjo clirohet teresisht apo pjeserisht sipas vendimit te Komisionit te Apelimit te Taksave dhe Tarifave Vendore, brenda 30 diteve kalendarike nga data kur eshte marre ose vleresohet te jete marre vendimi nga aria e Struktures Vendore te Apelimit
3. Nëse Komisioni i Apelimit lë në fuqi vendimin e Drejtorisë së të Ardhurave dhe taksapaguesi e pranon vendimin (nuk paraqet ankim ne Gjykate Administrative brenda afatit 30- ditor nga marrja dijeni për këtë vendim), çdo detyrim tatimor, që përfshin taksën apo tarifën, në rastin kur nuk është paguar, ose është vendosur garanci, kamatëvonesë dhe çdo gjobë e llogaritur, paguhen nga taksapaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga ana e Komisionit të Apelimit.

Neni 15

Ekzekutimi i vendimit te Komisionit te Apelimit dhe ankimi ne gjykate

1. Vendimi i Komisionit të Apelit ekzekutohet pas njoftimit të këtij vendimi.

2. Nëse nuk është dakord, me vendimin e Komisionit të Apelit, taksapaguesi mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

3. Nëse Komisioni i Apelit nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankojë drejtpërdrejtë në Gjykatë.

Neni 16
Dispozitë kalimtare.

Në rast ndryshimi të ndonjë prej akteve ligjore dhe nënligjore referuese, ndryshimet duhet të reflektohen në këtë rregullore.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
Dhimitraq Toli

